

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“D TechPulse” Sh.p.k.

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kodin Civil, në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe në ligjin Nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, i nënshkruari si vijon:

1. **Z. Syed Jawed Ali Roomi**, me atësi S.M. Shakir Roomi dhe mëmësi Saba Roomi, shtetas Pakistanez dhe mbajtës i pashaportës me numër AB9298813, lindur më 01.06.1976, në Sukkur dhe banues në Pakistan në adresën: R-175 Block #F Gulshan-E-Jamal Karachi;

në cilësinë e Ortakut të vetëm të shoqërisë, me vullnet të plotë e të lirë nënshkruan sot më datë 26.11.2024, Akt Themelimit (të inkomporuar në këtë Statut) me qëllim themelimit e kësaj shoqërie sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

KREU I

EMRI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA, KOHËZGJATJA DHE KAPITALI THEMELTAR

NENI I


Emri i Shoqërisë, Data e Themelimit dhe Themeluesit

- 1.1. Emri i shoqërisë është “D TechPulse” Sh.p.k.
- 1.2. Shoqëria themelohet më datë 26.11.2024 në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.
- 1.4. Themeluesi i shoqërisë është:
 - a) **Z. Syed Jawed Ali Roomi**, me atësi S.M. Shakir Roomi dhe mëmësi Saba Roomi, shtetas Pakistanez dhe mbajtës i pashaportës me numër AB9298813, lindur më 01.06.1976, në Sukkur dhe banues në Pakistan në adresën: R-175 Block #F Gulshan-E-Jamal Karachi.

NENI II

Forma Ligjore

- 2.1. Shoqëria “D TechPulse” Sh.p.k., (këtu e në vijim referuar si “Shoqëria”) është e themeluar dhe organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet nga ky Statut dhe ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 2.2. Shoqëria do të operojë në përputhje të plotë me ligjet në fuqi të Republikës së Shqipërisë.



Roomi

NENI III

Objekti i Veprimtarisë

- 3.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u përqendruar në kontraktimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme të biznesit kryesisht lidhur me zhvillimin e softwareve dhe hardwareve.
- 3.2 Shoqëria mund të ndërmarrë dhe kryejë edhe aktivitete të tjera në Shqipëri dhe jashtë saj, të cilat nuk janë të parashikuara në pikën 1 të nenit 3, por që janë të nevojshme dhe të domosdoshme në përmbushjen e objektit të veprimtarisë.

NENI IV

Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Ndërtesa 116, Ish Qendra Gurten, Rr. e Kavajës, Njesia Administrative Nr.10, Tiranë.
- 4.2 Vendimi për transferimin e selisë së Shoqërisë është kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.3 Çelja e degëve dhe zyrave të përfaqësimit në qytete të tjera ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë edhe mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër.

NENI V


Kohëzgjatja

- 5.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar.

NENI VI

Kapitali Themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i Shoqërisë është 20 000 (njëzetë mijë) Lekë.
- 6.2. Numri total i kuotave është 1 (një).
- 6.3. Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e Shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtëm:
 - a) **Z. Syed Jawed Ali Roomi**, me atësi S.M. Shakir Roomi dhe mëmësi Saba Roomi, shtetas Pakistanez dhe mbajtës i pashportës me numër AB9298813, lindur më 01.06.1976, në Sukkur dhe banues në Pakistan në adresën: R-175 Block #F Gulshan-E-Jamal Karachi, i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 20 000 (njëzetë mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.



Roomi

- 6.4. Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjestim të drejtë me pjesëmarrjen që zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë. Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta për të nënshkruar pjesën e tyre, kapitali i panëshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën e nënshkrimit të kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me aksionet e pjesëmarrjes në shoqëri.
- 6.5. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë Kapitalin Themeltar në çdo moment, të konsideruar të nevojshëm për të realizuar qëllimin e themelimit të Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme mund të emetojë kuota me vendimmarrjen prej të paktën 60% të ortakëve që zotërojnë kuota me të drejtë vote.
- 6.6. Kuota mund të shitet, dhurohet ose transferohet palëve të treta nga Asambleja e Përgjithshme me vendimmarrjen prej të paktën 60% të ortakëve që zotërojnë kuota me të drejtë vote.
- 6.7. Nëse kuotat zotërohen nga dy ose më shumë ortakë dhe njëri prej tyre dëshiron të shesë, dhurojë ose transferojë kuotat e tij, ai duhet të respektojë të drejtën e parablerjes. Në raste të tilla, përparësia e parë do t'i jepet ortakut që zotëron përqindjen më të madhe të kuotave, i ndjekur nga ortakët e tjerë në rend zbritës sipas përqindjeve të tyre të pronësisë.


KREU II

ORGANET E SHOQËRISË

NENI VII

Asambleja e Përgjithshme


- 7.1. Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 7.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij, si dhe të votojë në përputhje me të drejtat që rrjedhin nga kuota që zotëron, apo pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri. Të drejtën e votës në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme e kanë vetëm ortakët të cilët zotërojnë kuota me të drejtë vote.
- 7.3. Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 7.4. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht pjesën e mbetur.
- 7.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të



Romi

- quhet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj apo Sekretari i mbledhjes (të caktuar sipas rastit), me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 7.6. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 25% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e banimit, në adresat e email, ose në adresat e tjera të njoftuara Shoqërisë (nëse janë njoftuar të tjera), të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
 - 7.7. Asambleja e Përgjithshme do të konsiderohet e mbledhur rregullisht, pavarësisht nga sa më sipër, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
 - 7.8. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët, ose nga ortakët që zotërojnë kuota me të drejtë vote, të caktuar sipas rastit. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
 - 7.9. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga Kryetari dhe Sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
 - 7.10. Asambleja e Përgjithshme mblidhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
 - 7.11. Vendimet e vlefshme nga Asambleja e Përgjithshme kërkojnë miratimin e të paktën 60% të totalit të kapitalit të zotëruar nga ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre. Nëse ky prag nuk plotësohet, Asambleja e Përgjithshme thirret për një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja fillestare.
 - 7.12. Asambleja e Përgjithshme vendos me vendimarrjen e 60% të ortakëve me të drejtë vote, ose përfaqësuesit e tyre, për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.
 - 7.13. Asambleja e Përgjithshme është kompetente për çështjet e mëposhtme:
 - a) Ndryshimet dhe shtesat e Statutit të Shoqërisë;
 - b) Zmadhimin dhe/ose Zvogëlimin e kapitalit themeltar;
 - c) Blerjen, Bashkimin, Shkrirjen, Transformimin dhe procesin e Likuidimit të Shoqërisë;
 - d) Emërimin dhe Shkarkimin e Administratorit;
 - e) Emërimin dhe Shkarkimin e Kontabilistëve të Certifikuar, Miratimin e Pasqyrave Financiare pas verifikimit nga Kontabilisti i certifikuar;
 - f) Emetimin e kuotave;
 - g) Emërimi i Likuiduesve në rast të procesit të likuidimit përveç rasteve të falimentimit;
 - h) Përcaktimin e pagës, bonuseve si dhe kohëzgjatjen e emërimit të Administratorit;
 - i) Çështje të tjera në ngarkim të Asamblesë nga ligji dhe ky Statut.


NENI VIII



R. Kocmi

Administratori

- 8.1. Administratori i parë i Shoqërisë "D TechPulse" Sh.p.k. emërohet **Z. Syed Jawed Ali Roomi**, me atësi S.M. Shakir Roomi dhe mëmësi Saba Roomi, shtetas Pakistanez dhe mbajtës i pashaportës me numër AB9298813, lindur më 01.06.1976, në Sukkur dhe banues në Pakistan në adresën: R-175 Block #F Gulshan-E-Jamal Karachi, për një periudhë 5 (pesë) vjecare, duke filluar nga 26.11.2024 – 25.11.2029, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2. Shpërblimi për Administratorin caktohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë. Për Administratorin, si dhe për të gjithë punonjësit e tjerë, Shoqëria është e detyruar të paguajë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
- 8.3. Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 8.4. Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut i'a rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 8.5. Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 8.6. Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 8.7. Administratori është përgjegjës për:
 - a) Manaxhimin e veprimtarisë së biznesit me implementimin e politikave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
 - b) Prezantimin e shoqërisë përpara palëve të treta;
 - c) Mbikqyrjen e mbajtjes së Librave të Kontabilitetit dhe dokumenteve të tjera të nevojshme;
 - d) Përgatitjen dhe nënshkrimin e Pasqyrave Financiare, Llogarive të Konsoliduara dhe raportin vjetor të përformancës së shoqërisë, si dhe paraqitjen e dokumenteve në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për miratim së bashku me propozimin dhe shpërndarjen e fitimeve;
 - e) Krijimin e një sistemi paralajmërues për zhvillimet që mund të çenojnë shoqërinë;
 - f) Raportimin në Asamblesë e Përgjithshme mbi implementimin e politikave të të bërit biznes dhe realizimin e transaksioneve me rëndësi të vecantë për performancën e shoqërisë;
 - g) Kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji ose Statuti;



Roomi

- h) Përfaqësimin e Shoqërisë përpara çdo institucioni publik apo privat, financiar, jo-financiar, organi publik apo privat, organi tatimor, administrativ, gjyqësor, prokurori, etj.
- 8.8. Administratori ruan konfidencialitetin e të gjithë informacionit pronësor dhe sensitiv në lidhje me sekretet tregtare, të dhënat financiare, planet e biznesit, strategjitë e marketingut, formulimet e produkteve, listat e klientëve, informacionin e çmimeve dhe çdo informacion tjetër që nuk njihen nga të tjerët.
- 8.9. Administratori nuk duhet të zbulojë informacione konfidenciale kundrejt asnjë pale të tretë dhe as nuk do t'i përdorë këto informacione për ndonjë qëllim tjetër përveç përfitimit të shoqërisë, pa pëlqimin paraprak me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme. Gjithashtu duhet të ushtrojë kujdesin e duhur dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur informacionin konfidencial nga aksesimi, zbulimi ose keqpërdorimi i paautorizuar.
- 8.10. Administratori duhet të respektojë dhe mbrojë të drejtat e pronësisë intelektuale të shoqërisë, duke përfshirë markat tregtare, të drejtat e autorit dhe patentat, dhe nuk do të përdorë ose zbulojë një pronë të tillë intelektuale pa autorizimin paraprak me shkrim nga Asambleja e Përgjithshme.
- 8.11. Administratori mund të autorizojë palë të treta për kryerjen e veprimeve të ndryshme, të tilla si: depozitimin e Pasqyrave Financiare në Qendrën Kombëtare të Biznesit, përfaqësimin e Shoqërisë para institucioneve shtetërore, etj., përveç rasteve të parashikuara si kompetencë ekskluzive e Administratorit nga ligji ose ky Statut.

KREU III

MBARIMI, LIKUIDIMI, TË NDRYSHME


NENI IX

Mbarimi

- 9.1. Shoqëria mbaron:
- a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - b) me çeljen e procedurës së falimentimit;
 - c) nëse nuk ka kryer veprimtari biznesi për 2 (dy) vjet dhe nuk ka njoftuar më parë statusin inaktiv sipas ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”; ose
 - d) me vendim gjyqësor.
- 9.2. Administratori ose çdo person i autorizuar prej tij do të depozitojë raportin e mbarimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me ligjin Nr.9723 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

NENI X

Likuidimi



- 10.1. Pas vendimit për mbarimin e Shoqërisë, do të hapet procedura e likuidimit, përveç rasteve kur ka filluar një procedurë falimentimi.
- 10.2. Për kryerjen e procesit të likuidimit, Asambleja e Përgjithshme emëron 1 (një) ose disa likuidues, për qëllim hartimin e raportit të aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë, deri në mbarim të procesit të likuidimit.
- 10.3. Procesi i likuidimit do të bëhet në përputhje me ligjin 9901 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.
- 10.4. Pas pagesës së likuiduesve, kapitali i mbetur i Shoqërisë do t’i shpërndahet Asamblesë së Përgjithshme.

NENI XI


Viti Financiar, Kontrolli Financiar, Bilanci Vjetor dhe Dividenti

- 11.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të Shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 dhjetor.
- 11.2. Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.
- 11.3. Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë, si dhe llogaritë vjetore.
- 11.4. Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
- 11.5. Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga ligji “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të ortakëve zotërues të kuotave me të drejtë vote në Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- 11.6. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjithë dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.

NENI XII

Të ndryshme

- 12.1. Të gjitha situatat që nuk parashikohen nga ky Statut do të rregullohen nga ligji shqiptar Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar.



Handwritten signature in blue ink, appearing to read "L. Lami".

- 12.2. Të gjithë dokumentet për palët e treta, të tilla si njoftime, publikime, dhe faturime etj., do të pëfshijnë emrin e Shoqërisë së bashku me shkurtimet “Sh.p.k.”, selinë, emrin e administratorit ose të të autorizuarit prej tij.
- 12.3. Bazuar në ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të regjistrohen në Regjistrin e mbajtur për këtë qëllim.
- 12.4. Shoqëria ka të drejtë të punësojë punëmarrës për të ushtruar aktivitetin e saj duke zbatuar parashikimet e Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.
- 12.5. Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen me marrëveshje ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore jashtë gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.
- 12.6. Ky statut është i draftuar në 2 dy) kopje origjinale me fuqi të njëjtë juridike.

NENI XIII

Miratimi

- 13.1 Statuti i Shoqërisë tregtare, “D TechPulse” sh.p.k. Tiranë, pasi lexohet nen për nen nga ortakët dhe janë plotësisht dakort me të, në kuadrin ligjor të organit vendimmarrës e miratojnë duke e nënshkruar.

“D TechPulse” Sh.p.k.

Ortaku i vetëm

Z. Syed Jawed Ali Roomi

